



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.90 /2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 28.02.2020 shqyrtoi ankesat me:

Objekt: “Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “A.M.U” shpk nga procedura e prokurimit “Kërkesë për propozime”, me objekt “Blerje materiale te ndryshme per SHA Ujesjelles-Kanalizime Librazhd-Prrenjas”, me Nr. REF-46953-12-30-2019, me fond limit 3 000 000 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datën 10.01.2020 nga autoriteti kontraktor Sh.a Ujesjelles Kanalizime Librazhd”.

Ankimues: “Alen-Co” shpk
Rruga “Tish Daija”, hyrja 3, apartment 22, Zk.8260, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Sh.a Ujesjelles Kanalizime Librazhd
Sheshi Agjencisë, Librazhd.

Subjekte të Interesuara: “A.M.U” shpk
Adresa: Autostrada Fushë-Krujë - Laç, km 1.5, Fushë-Krujë, Durrës.

“Ermi-Pump” shpk
Fshati Hasan, ndërtesë private 1 katëshe, zona kadastrale nr. 1934,
me numër pasurie 6/17 Fushë Krujë, Durrës.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1 Në datën 31.12.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë për propozime”, me objekt “Blerje materiale te ndryshme per SHA Ujesjelles-Kanalizime Librazhd-Prrenjas”, me Nr. REF-46953-12-30-2019, me fond limit 3 000 000 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datën 10.01.2020 nga autoriteti kontraktor Sh.a Ujesjelles Kanalizime Librazhd”.

II.2. Në datën 15.01.2020 operatorët ekonomikë pjesëmarrës, janë njoftuar elektronikisht nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi klasifikimin e ofertave gjatë procesit të vlerësimit, si dhe ofertuesit e kualifikuar dhe të skualifikuar si vijon:

“A.M.U” shpk	2.941.198 lekë	Kualifikuar
“Alen – Co” shpk	2.963.770 lekë	Kualifikuar
“Ermi-Pump” shpk	2.992.470 lekë	Skualifikuar

II.3. Në datën 15.01.2020, operatori ekonomik “Alen-Co” shpk është njoftuar elektronikisht nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi klasifikimin e ofertave gjatë procesit të vlerësimit.

II.3.1. Në datën 20.01.2020 operatori ekonomik “Alen-Co” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar kualifikimin operatorit ekonomik “A.M.U” shpk. Konkretisht pretendohet si vijon:

“Shoqeria jone , pjesemarrëse ne proceduren e prokurimit me objekt "Blerje materiale te ndryshme per SHA Ujesjelles-Kanalizime Librazhd-Prrenjas", eshte njoftuar nepermjet portalit te prokurimeve publike ne daten 15.01.2020 mbi renditjen e ofertave ekonomike te operatoreve garues.

Oferta e shoqerise sone eshte shpallur e vlefshme dhe e dyta ne kete procedure prokurimi. Ndersa, shoqeria A.M.U. e klasifikuar e para ne kete procedure, sipas nesh eshte bere ne kundërshtim me LPP.

Ne si shoqeri, duke u bazuar dhe ne pervojen tone ne kete sektor, si dhe duke njohur mire jo vetem tregun, por edhe shoqerite e tjera konkurruese, kemi dyshime te forta se, operatori ekonomik A.M.U., i renditur i pari ne kete konkurrim, nuk ploteson kriteret e vecanta per kualifikim, te kerkuara nga ana e autoritetit Tuaj.

Ne dyshojme se, shoqeria A.M.U, nuk i ka paraqitur te gjitha dokumentat e kerkuara ne tender dhe/ose dokumentat e paraqitura nuk jane te sakta dhe/ose jane falsifikuar dhe/ose ka nderhyrje ne dokumentat e paraqitur ndyshe nga c'mund te jene dokumentat origjinale.

Konkretisht:

- 1) autorizimet e prodhuesit per mallrat objekt prokurimi, te kerkuar ne paragrafin 4 te pikes 2.3 "Kapaciteti teknik";*
- 2) skedat teknike dhe kataloget e produkteve per mallrat objekt prokurimi, te kerkuar ne paragrafin 3 te pikes 2.3. "Kapaciteti teknik";*
- 3) certifikatat e konformitetit per mallrat objekt prokurimi , te kerkuar ne paragrafm 4 te pikes 2.3 "Kapaciteti teknik".*

Lidhur sa me siper, shoqeria jone kerkon qe, pas rishikimit me objektivet dhe kujdes te madh te te gjithë dokumentave te paraqitura nga operatori A.M.U., te behet skualifikimi i ketij operatori per mospermbushje te kriterëve per kualifikim dhe/ose specifikimeve teknike te produkteve qe ka ofruar”.

II.3.2. Me anë të shkresës shkresën nr. prot.1/8, datë 29.01.2020 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje shoqërisë “Alen-Co” shpk, ku ka vendosur mospranimin e ankesës.

II.3.3 Në datën 03.02.2020 operatori ekonomik “Alen-Co” shpk ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik me të njëjtin objekt si edhe në autoritetin kontraktor.

II.4. Në datën 14.02.2020 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr.prot.129/2 shkresa e autoritetit kontraktor nr.1/11, date 12.02.2020, ku bashkëngjitur ndodhet dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre si dhe dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, në zbatim të nenit 30 pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, në të cilin parashikohet se “1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre”, nisur nga natyra e procedurës, interesi publik, objekti i prokurimit, vlera e kontratës të kësaj procedure prokurimi dhe kompleksitetit e specifikës së saj, referuar edhe ankesës së paraqitur nga ankimuesi, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me vendimet dhe veprimet e ndërmarra nga autoritetit kontraktor në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III.1.1. Marrë shkas nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Alen-Co” shpk lidhur me kualifikim të padrejtë të operatorit ekonomik “A.M.U” shpk nga verifikimi i kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, të bazë të të cilave është bërë më pas edhe shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, kriteri për të cilin ankimuesi ngre pretendime ka shkaktuar konfuzion e paqartësi në mënyrën e përmbushjes së tij, e konkretisht vëren se:

III.1.2. Në shtojcën 8 “Kriteret e Vecanta për Kualifikim”, “Kapaciteti Teknik” pika 2.3.4 të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

“4- Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese autorizim prodhuesi ose distributori zyrtare per mallrat objekt prokurimi per lejim tregetimi te mallrave objekt prokurimi ne R.Sh, kjo e vertetuar

nepermjet dokumentave orgjinal si perfaqesues i kompanise prodhuese per te gjithë mallin/mallrat objekt prokurimi.Ne rast paraqitje autorizimi distributori, OE duhet te paraqesi nje leter angazhim ose akt marreveshje midis prodhuesit dhe distributorit e vlefshme midis tyre ne kohen e zhvillimit te tenderit.Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail,  ebsite kjo e nevojshme per autoritetin kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.  ertifikata e Konformitetit k rkohet p r t  gjith  artikujt sipas preventivit, n se do ishte ndryshe do ta kishim p rcaktuar n  dokumentat standarte t  tenderit.

 ertifikata e Konformitetit duhet t  d shmoj se produktet e k rkuara jan  n  p rputhje me normat europiane pra kan  p rputhshm ri europiane dhe lejohen p r treg tim n  komunitetin europian sipas direktives 89/106/CEE ndryshuar me direktiven 93/68/CEE te Unionit Europian.Kjo n  kuad r t  unifikimit t  legjislacionit ton  me at  t  Bashkimit Europian sipas "Acquis Communautaire".

III.1.3. N  tabel n e list s s  preventivit, pjes  integrale e dokumentave t  procedur s s  prokurimit objekt ankimi, p rcaktohen t  dh nat teknike si m  posht :

Kart sistem Pershkrim Gr.Postimi

Inventari Njesia Sasia Cmimi pa

tvsh Vlera Specifikimet teknike

ART-0729 Ajruse 1 " PE&PP cop 10 PE

ART-0730 Ajruse 2 " PE&PP cop 10 PE

*ART-0020 Bashkues PE   75*63 PE&PP cope 10 16ATM*

*ART-0004 Bashkuese PE   90*75 PE&PP cope 10 16ATM*

ART-0621 Bashkuese PE   110 PE&PP cop 5 16ATM

ART-0021 Bashkuese PE   20 PE&PP cope 100 16ATM

*ART-0642 Bashkuese PE   20*25 PE&PP cop 50 16ATM*

ART-0022 Bashkuese PE   25 PE&PP cope 100 16ATM

ART-0026 Bashkuese PE   32 PE&PP cope 100 16ATM

*ART-0013 Bashkuese PE   32*25 PE&PP cope 10 16ATM*

ART-0033 Bashkuese PE   40 PE&PP cope 100 16ATM

ART-0034 Bashkuese PE   50 PE&PP cope 50 16ATM

ART-0006 Bashkuese PE   63 PE&PP cope 30 16ATM

*ART-0008 Bashkuese PE   63*50 PE&PP cope 10 16ATM*

ART-0002 Bashkuese PE   75 PE&PP cope 10 16ATM

ART-0480 Bashkuese PE   90 PE&PP cope 20 16ATM

*ART-0618 Bashkuese redukt.   40*25 PE&PP cop 10*

ART-0084 Bryla   1/2" XINGATO cope 50

ART-0058 Bryla   1 1/4" XINGATO cope 30

Bryla   100 (45" rezistence) PE&PP cop 8

Bryla   100 (90" rezistence) PE&PP cop 8

*ART-0498 Bryla PE   20*1/2 M PE&PP cope 20*

ART-0073 Bryla PE Ø 25 PE&PP cope 100
 ART-0075 Bryla PE Ø 63 PE&PP cope 10
 ART-0522 Bryla PP Ø 25* Th PE&PP cope 50
 ART-0068 Bryla PP Ø 32 th PE&PP cope 20
 ART-0437 Cimento EL&ND kv 60 M-400
 ART-0608 Dado & bulona Ø 12-18 EL&ND cop 50
 ART-0093 Ele (30*30) EL&ND ml 100
 ART-0100 Fije lini EL&ND cope 100
 ART-0102 Flete sharre hekuri EL&ND cope 100
 ART-0441 Granil tullash EL&ND m3 10
 ART-0115 Hekur φ 10 EL&ND kg 100
 ART-0516 Hekur φ 6 EL&ND kg 50
 ART-0128 Hollandez Ø 1 1/4" XINGATO cope 10 16ATM
 ART-0649 Hollandez PE Ø 110 PE&PP cop 6 16ATM
 ART-0576 Hollandez PE Ø 25* 1/2 PE&PP cop 100 16ATM
 ART-0574 Hollandez PE Ø 40*1 1/2 " PE&PP cop 10 16ATM
 ART-0575 Hollandez PE Ø 40*1 1/4 PE&PP cop 10 16ATM
 ART-0573 Hollandez PE Ø 50*1 " PE&PP cop 10 16ATM
 ART-0572 Hollandez PE Ø 50*1 1/4" PE&PP cop 30 16ATM
 ART-0469 Hollandez PE Ø 50*2" PE&PP cope 15 16ATM
 ART-0427 Hollandez PE Ø 90*3" PE&PP cope 10
 ART-0145 Hollues boje EL&ND kg 30
 ART-0241 Kapak puseta gize XINGATO cope 10 RRETHORE
 Kundravalvula Ø 50 XINGATO cop 2
 ART-0440 Kyca EL&ND cope 50
 ART-0167 Litar kerpi EL&ND kg 10
 Litar pllak EL&ND cop 10
 ART-0454 Lllamarine e zeze EL&ND m2 20 2X1X1,5mm
 ART-0175 Manikota Ø 1' XINGATO cope 50
 ART-0198 Manikota Ø 2 1/2" XINGATO cope 10
 ART-0178 Manikota Ø1 1/4" XINGATO cope 100
 Manikota PE Ø 100 PE&PP cop 20 Me rezistence, 16 ATM
 Manikota PE Ø 75 PE&PP cop 20 Me rezistence, 16 ATM
 ART-0191 Manikota PP Ø 25 PE&PP cope 100 th
 ART-0217 Ngjites PVC EL&ND kuti 10
 ART-0223 Niplas Ø 1 1/4" XINGATO cope 20
 ART-0493 Niplas Ø 1" XINGATO cope 50
 ART-0218 Niplas Ø 1/2" XINGATO cope 200
 ART-0230 Niplas Ø 3/4" XINGATO cope 150
 ART-0236 Pasta filetimi EL&ND kuti 20
 ART-0237 Plumb EL&ND kg 30 I paster

ART-0645 Qafore PE Ø 110 PE&PP cop 15
ART-0617 Qafore PE Ø 40 PE&PP cop 30
ART-0616 Qafore PE Ø 50 PE&PP cop 30
ART-0615 Qafore PE Ø 63 PE&PP cop 30
ART-0643 Qafore PE Ø 75 PE&PP cop 30
ART-0644 Qafore PE Ø 90 PE&PP cop 30
ART-0249 Reduksion Ø 1 1/2*3/4" XINGATO cope 10
ART-0260 Reduksion Ø 2*1 1/2" XINGATO cope 10
ART-0261 Reduksion Ø 2*1 1/4" XINGATO cope 10
ART-0490 Reduksion Ø 3/4*1/2" XINGATO cope 100
Reduktor presioni Ø 50 XINGATO cop 2
Reduktor presioni Ø 50 XINGATO cop 1
ART-0439 Rere e lare EL&ND m3 10
ART-0306 Saracineska Ø 1 1/2" me leve XINGATO cope 10
ART-0307 Saracineska Ø 1 1/4" me leve XINGATO cope 10
ART-0294 Saracineska Ø 1/2 me volant XINGATO cope 50
ART-0425 Saracineska Ø 1/2" me leve XINGATO cope 100
ART-0310 Saracineska Ø 2" me leve XINGATO cope 10
ART-0311 Saracineska Ø 3" me leve XINGATO cope 5
ART-0312 Saracineska Ø 3/4" me leve XINGATO cope 30
ART-0468 Saracineske Ø 1" me leve XINGATO cope 20
Saracineske Ø 100 XINGATO cop 1
ART-0496 Tapa Ø 3/4" XINGATO cope 100
ART-0648 Tia PE Ø 110 PE&PP cop 5
ART-0361 Tia PE Ø 40 PE&PP cope 10
ART-0366 Tia PE Ø 50 PE&PP cope 20
ART-0609 Tub HDPE Ø 140 brinjezuar TUBA KANALIZIME ml 60
ART-0610 Tub HDPE Ø 160 brinjezuar TUBA KANALIZIME ml 30
ART-0651 Tub PP Ø 110 brinjezuar TUBA KANALIZIME cop 60
ART-0398 Tub PP Ø 200 brinjezuar TUBA KANALIZIME ml 60
ART-0529 Tub PP Ø 250 brinjezuar TUBA KANALIZIME ml 60
ART-0589 Tub PE Ø 20 (16 ATM) TUBA ml 1000
ART-0588 Tub PE Ø 25 (16 ATM) TUBA ml 1000
ART-0587 Tub PE Ø 32 (16 ATM) TUBA ml 500
ART-0659 Tub PE Ø 110 (16 ATM) TUBA ml 100
ART-0586 Tub PE Ø 40 (16 ATM) TUBA ml 1000
ART-0585 Tub PE Ø 50 (16 ATM) TUBA ml 800
ART-0731 Tub PE Ø 75 (16 ATM) TUBA KANALIZIME ml 100
ART-0625 Tub PE Ø 90 (16 atm) TUBA ml 200
ART-0732 Tub PP Ø 125 brinjezuar TUBA KANALIZIME ml 60
ART-0401 Tub PP Ø 315 brinjezuar TUBA KANALIZIME ml 60

Tub PP Ø 500 brinjezuar TUBA ml 6
ART-0467 Tub PVC Ø 110 (10atm) TUBA KANALIZIME ml 60
ART-0528 Tub PVC Ø 140 (10atm) TUBA KANALIZIME ml 60
ART-0641 Valvula me kthim Ø 1/2 XINGATO co 50
Reflektor ngrohje cop 5
VLERA PA TVSH LEKE
TVSH LEKE
VLERA ME TVSH LEKE

III.1.4. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Ndërsa në nenin 28/2 të VKM 914/2014 përcakohet se: *“2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

III.1.5. Sa më sipër analizuar, gjykojmë se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtë përdrejtë me kriterin e vecantë të vendosur.

III.1.6. Lidhur me kërkesën e autoritetit kontraktor për paraqitjen e certifikatës së konformitetit për produktet e kërkuara, të cilat duhet të jenë në përputhje me normat europiane, sipas direktives 89/106/CEE ndryshuar me direktiven 93/68/CEE të Unionit Europian, konstatojmë, se autoriteti kontraktor nuk ka përcaktuar qartësisht standartin të cilit duhet t’i referohen operatorët ekonomikë pjesmarrës, duke mos përcaktuar saktë legjislacionin primar të BE-së, pra duke mos vendosur qartë referencën, për më tepër duke e lënë në mënyrë të papërcaktuar dhe evazive, duke mos dhënë kështu asnjë orientim konkret në lidhje me standardin e kërkuar për operatorët ekonomikë pjesmarrës në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III.1.7. Marrë shkas nga pretendimet e ankimuesit “Alen-Co” shpk, në ankesë se operatori ekonomik “A.M.U” shpk i kualifikuar nga autoriteti kontraktor nuk e përmbush kriterin e kualifikimit për certifikatat e konformitetit, pasi *dokumentat e paraqitura nuk janë te sakta*, KPP referuar edhe dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “A.M.U” shpk, gjykon se

procedura e prokurimit objekt ankimi shfaq të meta në mënyrën e hartimit të kriterit të kualifikimit e konkretisht mbi mënyrën e përmbushjes së certifikatave të konformitetit.

III.1.8. Gjithashtu për shkak të kompleksitetit të çështjes dhe për shkak se kriteri i vecantë i kualifikimit i përcaktuar në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi, lidhur me plotësimin e direktivës së kërkuar është një kriter shumë i përgjithshëm i cili kërkon detajim të të dhënave në lidhje me certifikatat e konformitetit të kërkuara, KPP gjykon se në rastin konkret kriteri i vecantë i kualifikimit i sipërpërmendur duke qenë një kriter i paqartë, ka shkaktuar konfuzion tek operatorët ekonomikë pjesmarrës në lidhje me atë cka është kërkuar dhe, akoma më tej tek anëtarët e vlerësimit të procedurës, të cilët kanë konsideruar të përmbushur dhe të provuar direktivën e kërkuar, për shkak se vetë kriteri është abstrakt dhe i paqartë duke mos i dhënë rëndësinë e duhur mënyrës së përmbushjes së tij.

Në këto kushte KPP gjykon se kriteri i hartuar në një formë të tillë të përgjithshme për një standard i cili ka lidhje direkte me cilësinë e mallit me të cilën do të furnizohet autoriteti kontraktor për një objekt të rëndësishëm, ka shkaktuar konfuzion edhe ndërmjet anëtarëve që kanë vlerësuar procedurën lidhur me mënyrën e përmbushjes së tij nga operatorët ekonomikë pjesmarrës sa kohë që nuk është specifikuar në mënyrë të saktë e të qartë.

KPP gjykon se autoriteti kontraktor në hartimin e këtij kriteri duhet të ishte treguar i qartë dhe i kujdeshëm në përputhje me rëndësinë që ky kriter paraqet dhe që ka lidhje me cilësinë e mallit, në mënyrë që t'i krijohej panorama e qartë të gjithë pjesmarrëve mbi kapacitetet e kërkuara, dhe akoma më tej për të evituar cdo lloj vlerësimi subjektiv të ofertuesve.

III.1.9. Vlen të theksohet se, kriteret e kualifikimit, nga autoriteti kontraktor duhet të përcaktohen të qarta, të sakta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, volumin dhe objektin e kontratës objekt prokurimi me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jo diskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi, si dhe duke mos i dëmtuar pjesëmarrësit. Mospërcaktimi i saktë i kriterit të mësipërm, shkel parimin e mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, nxitjes së konkurrencës dhe pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit, pasi përcaktimi i këtij kriteri si më sipër cituar, ka shkaktuar konfuzion gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave.

Kriteret e kualifikimit duhet të jenë të qarta, të sakta dhe të mirëpërcaktuara nga autoriteti kontraktor me qëllim që të jenë sa më të kuptueshme jo vetëm për operatorët ekonomikë të interesuar për të qënë pjesëmarrës, komisionin e vlerësimit të ofertave në mënyrë të tillë që procesi i vlerësimit të mos kryhet me subjektivizëm, por të vendosë në situatë të barabartë edhe për personat me aftësi të kufizuar, duke mos penguar kështu pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi.

Në kushtet kur konstatohet se kriteri i sipërcituar lidhur me përmbushjen e certifikatave të konformitetit nuk e ka plotësuar kushtin e qartësisë, ka krijuar konfuzion tek operatorët ekonomikë ashtu edhe tek autoriteti kontraktor gjatë vlerësimit të ofertave, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, situata e tillë përbën shkak për anulimin e procedurës së prokurimit bazuar në nenin 64, pika 3 të LPP-se.

Gjithashtu në nenin 31, pika 2 gërma “d” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”,

parashikohet se: “[...] Komisioni, pas shqyrtimit administrativ të ankesës vendos me akt të motivuar: d) Të anulojë procedurat për shpalljen e kontratës fituese dhe të udhëzojë autoritetin kontraktor për rifillimin e procedurës së prokurimit [...]”.

Në rastin konkret rezulton se autoriteti kontraktor ka vlerësuar mbi kriteret e paqarta, evazive dhe të hartuara jo në përputhje me nenin 28/2 të VKM 914/2014, mbi të cilat ka bërë edhe vlerësimin dhe kualifikimin e operatorëve ekonomikë. Në këtë situatë Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se procedura e prokurimit duhet të anulohet për shkaqet e sipërcituara.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit “Alen-Co” shpk nuk do të merret në shqyrtim.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Alen-Co” sh.p.k. mbi kualifikimin e shoqërisë “A.M.U” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk do të merren në shqyrtim pasi, referuar gjykimit mësipërm në pikën III.1, procedura në fjalë do të anulohet.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Alen-Co” shpk për procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozime”, me objekt “Blerje materiale te ndryshme per SHA Ujesjelles-Kanalizime Librazhd-Prenjas”, me Nr. REF-46953-12-30-2019, me fond limit 3 000 000 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datën 10.01.2020 nga autoriteti kontraktor Sh.a Ujesjelles Kanalizime Librazhd”.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Alen-Co” shpk.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 129 Protokolli; Datë 03.02.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Nënkryetar
Enkeleda Bega**

**Anëtar
Vilma Zhupaj**

**Anëtar
Lindita Skeja**

**Anëtar
Merita Zeqaj**

**Kryetar
Evis Shurdha**